

N.H. "IBËR-LEPENC" SH.A.  
D.D.  
01- 4075 Dt. 30. 10. 2024  
PRISHTINË-PRIŠTINA



NDËRMARRJA HİDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" Sh.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo  
Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@iber-lepenc.org

Bazuar në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr.05/L-009 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Statutit Nr.08/868, të datës 30.05.2022, të NPH "Ibër Lepenc", si dhe Kodin e Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2023 mori këtë:

### V E N D I M

- Miratohet Plani i Biznesit i NPH "Ibër - Lepenc" Sh.A , për vitin 2025.
- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Biznesit për vitin 2025.

Dërguar:

Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike;  
Bordit të Drejtorëve/Sekretarit të Ndërmarrjes;  
Kryeshefit Ekzekutiv;  
Zyrtarit Kryesor Financiar  
Arkivit të NPH "Ibër Lepenc", Sh.A.

Datë: 30.10.2024



Bajram MUSTAFA  
Kryesues i Bordit të Drejtorëve  
të NPH "Ibër Lepenc", Sh.A.



NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE “**IBËR - LEPENC**” SH.A.

HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE “**IBËR - LEPENC**” J.S.C.

VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE “**IBËR - LEPENC**” D.D.

## **PLANI I BIZNESIT**

**2025**

**Tetor, 2024**

**PËRMBAJTJA**

<b>HYRJE .....</b>	3
<b>Misioni .....</b>	3
<b>Vizioni .....</b>	3
<b>Organizimi dhe qeverisja korporatave.....</b>	4
<b>Struktura Organizative .....</b>	4
<b>Korniza Ligjore.....</b>	6
<b>Objektivat Strategjike .....</b>	6
<b>SWOT Analiza .....</b>	7
<b>Përparësitë .....</b>	7
<b>Dobësitë .....</b>	7
<b>Mundësitë.....</b>	7
<b>Rreziqet .....</b>	7
<b>Veprimitaria .....</b>	8
<b>Energjia Elektrike.....</b>	8
<b>Uji i papërpunuar .....</b>	8
<b>Ujitja.....</b>	12
<b>Plani operativ dhe investiv .....</b>	13
<b>Gjenerimi i energjisë elektrike-.....</b>	13
<b>Ujitja me sipërfaqjet e planifikuara sipas Njësive Punuese dhe fushave për vitin 2025 .....</b>	14
<b>Investimet Kapitale.....</b>	16
<b>Departamenti Uji dhe Gjenerimi .....</b>	16
<b>Departamenti Ujitja.....</b>	19
<b>Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim .....</b>	20
<b>Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta .....</b>	21
<b>Planifikimi i Burimeve njerëzore .....</b>	24
<b>Personeli .....</b>	24
<b>Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.....</b>	25
<b>Planifikimi Financiar.....</b>	25
<b>Tabela 7 : PLANI I TË HYRAVE PËR VITIN 2025.....</b>	25
<b>Tabela 8 : PLANI I BUXHETIT NGA UJITJA PËR VITIN 2025 SIPAS FUSHAVE .....</b>	29
<b>Tabela 10 : REZULTATI FINANCIAR.....</b>	30
<b>Tabela 11 : PLANI I ZHVILERSIMIT TË ASETEVE PËR VITIN 2025 .....</b>	33
<b>Tabela : 13 PLANI I PROJEKTIT TË FINANCUAR ME KREDI TË BANKËS BOTËRORE .....</b>	35

## HYRJE

Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.A. me seli në Prishtinë është ndërmarrje shumë funksionale e cila furnizon industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë me ujë të papërpunuar si dhe prodhon energji elektrike nga Hidrocentrali i Ujmanit. N.H. Ibër-Lepenc është themeluar me Vendimin e Kuvendit të Kosovës me 28 shkurt 1967; me seli në Prishtinë. Ndërmarrja është shëndrruar në vitin 1986 në Ndërmarrje shoqërore me qëllim të operimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së këtij sistemi shumë funksional. Ndërtimi i këtij sistemi është paraparë të bëhet në dy fazë:

- IBRI (ka përfunduar në vitin 1986)
- LEPENCI (nuk është realizuar akoma)

Ndërmarrja është transformuar në Ndërmarrje Publike N.H. "Ibër-Lepenc" nga UNMIK-u pas vitit 2001. Pas Koorporatizimit të Ndërmarrjes, më 01/01/2008, Ndërmarrja është shëndrruar në Ndërmarrje Hidro-Ekonomike "Ibër-Lepenc" Sh.a.. Ndërmarrja është Shoqëri Aksionare në pronësi 100% të Qeverisë së Kosovës. Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike (Ligji nr. 03/ L-087) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin (Ligji nr. 04/L - 111) dhe (Ligjin nr.05/L-009) NH "Ibër-Lepenc" Sh.A. është njëra nga ndërmarrjet publike qendrore të Republikës së Kosovës e organizuar si Shoqëri Aksionare e cila sipas Ligjit për Shoqëri Tregtare (Ligji nr.06/L-016) përmes Bordit të Drejtoreve, i përgjigjet Qeverisë së Republikës së Kosovës si aksionar i vetëm. Plani i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes. Ky plan është përpiluar duke i pasur parasysh informatat e vitit 2024, trendet zhvillimore ndër vite dhe kërkesat e sektorëve, dhe ofron planifikim të detajuar lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për vitin 2025. Në këtë plan përshkruhet afarizmi vjetor i bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes me qëllim të ofrimit të të gjitha informatave të nevojshme të cilat janë të rëndësishme përmarrjen e vendimeve në ndërmarrje. Plani vjetor përvitit 2025 është detajisht i zbërthyer. Pjesa strategjike e këtij plani vazhdimesht monitorohet, rishqyrtohet dhe sipas nevojës mund të ndryshohet nga Bordi i Drejtoreve. Rëndësia e këtij plani është se i njëjtë do të shërbej përmarrje së Bordin dhe Menaxhmentin e ndërmarrjes, si platformë përmarrje së zhvillimin dhe vodosjen e prioriteteve të investimeve në të ardhmen.

## Misioni

Misioni i NH "Ibër - Lepenc" SH.A. është që të ofrojë shërbime sa më kualitative përmirësimi e eficencës, duke optimalizuar shfrytëzimin e kapaciteteve tona ujore që posedojmë e duke respektuar standarde tregtare, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Angazhimi i të gjitha resurseve njerzore, profesionale, përmirësimi e eficencës, duke optimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve tona ujore që posedojmë e duke respektuar standarde tregtare, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Realizimi i projekteve të investimeve kapitale, me ç'rast do të minimizojmë zhvlerësimin e aseteve të ndërmarrjes dhe në këtë mënyrë, do të shtohet vlera, cilësia, jetëgjatësia e aseteve dhe rritja e perfomancës së Ndërmarrjes në raport me funksionin e saj.

## Vizioni

Vizioni i NH "Ibër- Lepenc" SH.A. është operimi dhe mirëmbajtja e aseteve ekzistuese dhe rritja e investimeve kapitale, përmirësimi e shërbimeve cilësore ndaj klientëve ekzistues dhe atyre potencial, e që të pozicionohet si një nga kompanitë më të qëndrueshme në fushën e menaxhimit të burimeve ujore dhe energetike në nivel regional.

Nëpermes angazhimit shtesë të kontribuojmë në rritjen e sasisë së mundshme të gjeneruar të energjisë elektrike, për nevojat e popullsisë dhe industrisë, duke marrë në konsideratë infrastrukturën ekzistuese për të prodhuar energji të pastër dhe në këtë menyrë, duke kontribuar në reduktimin e emetimeve të karbonit në ekologjine vendore. Ndërmarrja synon të adoptojë teknologji të reja dhe inovacione eficente në menaxhimin e ujit dhe energjisë, duke u bërë një model për qëndrueshmerinë mjedisore dhe duke promovuar një kulturë të efikasitetit, eficencës dhe perqiegjësisë sociale.

Këtë vizion, synojmë ta arrijmë përmes kreativitetit/inovacioneve, përmiresimit të teknologjisë, adaptimit të përvojave të qeverisjeve koorporative ndërkombetare dhe trainimit të stafit profesional.

## Organizimi dhe qeverisja korporatave

### Struktura Organizative


Ndërmarrja "Ibër- Lepenc" Sh.A. mbikëqyret nga Bordi i Drejtoreve dhe udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Sipas strukturës organizative të ndërmarrjes Menaxhmenti i lartë i Ndërmarrjes përbëhet nga pozitat në vijim:

Kryeshefi Ekzekutiv (KE),  
Sekretari i Ndërmarrjes,  
Zyrtari Kryesor Financiar dhe  
Zyrtari për Auditim të Brendshëm.

Poashtu, menaxhmentin e Ndërmarrjes e përbëjnë edhe drejtoret Departamenteve dhe menaxherët e zyrave si në vijim:

- Departamenti Uji dhe Gjenerimi
- Departamenti Ujitja
- Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim
- Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta
- Njësia zbatuese e Projektit të Bankës Botërore
- Zyra për standarde, cilësi dhe politika menaxheriale
- Prokurimi
- Zyra e shitjes
- Çertifikuesi

Në organogramin e mëposhtëm është e paraqitur struktura organizative e ndërmarrjes:



Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Hidroekonomike "Ibër-Lepenc" sh.a, në mbledhje e mbajtur me datë 05.08.2024, miratoi Rregulloren Nr.01/3076 për ndyshimin dhe plotësimin e Rregullorës Nr. 08/2913, të datës 31.10.2023.

Në këtë rregullore ndryshohet rregullorja për sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës në ndërmarrje. Nryshimet janë bërë si në vijim:

1. Në Departamentin Uji dhe Gjenerimi, i shtohet: Shërbimi i Mirëmbajtjes së Liqenit, Digave dhe Infrastrukturës, me gjithësejt 30 punonjës.
2. Pozitës, Drejtues i kamionit, i ndryshohet koeficienti nga 300, në 350, dhe
3. Pozitës, Inxhinier i gjeodozisë dhe i Sistemit Gjeografik të Informimit (SGJI), i ndryshohet koeficienti nga 550 në 520.

## Korniza Ligjore

Ligji për Shoqëritë Tregtare (Ligji nr. 02/L-123), Ligji për Ndërmarrjet Publike - Ligji nr. 03/ L-087) dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/ L-087 (Ligji nr. 04/L - 111), të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës janë aktet më të larta të cilat e rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes. Dokumente tjera në bazë të të cilave udhëhiqet ndërmarrja janë: Statuti, Kodi i etikës dhe rregulloret e brendshme.

## Objektivat Strategjike

Mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese, modernizimi i sistemit, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve janë qëllime dhe synime të ndërmarrjes. Rritja e vlerës së aseteve, maksimalizimi i të hyrave me një shfrytëzim sa më efikas të aseteve mbetet prioritet i ndërmarrjes, ndërkaoq në planin strategjik zgjerimi i ndërmarrjes në aspektin e aseteve si dhe në aspektin e veprimitarës mbeten si qëllim.

Për projekte kapitale të mëdha të cilat nuk mund të financohen nga burimet e të hyrave vetanake dhe me qëllim të modernizimit të mëtejmë të infrastrukturës së Ibër Lepenc-it në planin strategjik afatshkurtër pritet që të negociohet mundësia e përfitimit të donacioneve apo huave të buta nga donatorë të mundshëm.


Qëllimi kryesor i ndërmarrjes dhe objektivat e këtij plani janë rritja e vlerës së aseteve, shfrytëzimi më i madh i kapaciteteve si dhe zgjerimi i veprimitarës e cila do të siguronte rritjen e të hyrave gjatë tri viteve të ardhshme.

Në kuadër të objektivave strategjike të karakterit madhor, gjithsesi do të mbetet edhe realizimi i projektit të "Lepenc-it" e që pritet së shpejti të dal në diskutim publik.

Një ndër objektivat strategjike për vitin 2025, është futja e ndërmarrjes sonë në Listën e Infrastrukturës Kritike e cila duhet të votohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Në planin e të të hyrave për vitin 2025 është paraparë që të hyrat nga shitja e energjisë elektrike të jenë rrëth **75.55 %** e të hyrave të përgjithshme. Shitja e ujit të papërpunuar merr pjesë me **20.71 %** të të hyrave, ndërsa ujita pritet të kontribuoj me **1.81 %** dhe nga të hyrat nga intereset prej **1.93 %**. Rritja e të hyrave nga uji i papërpunuar do të përmirësohet me rritjen dhe riaktivizimin e kërkuesave të industrisë në të ardhmen.

Në grafikonin e më poshtëm janë paraqitur të hyrat e planifikuar për vitin 2025 sipas veprimitarive të ndërmarrjes:



**Figura 1: Paraqitura grafiqe e pjesëmarrjes së të hyrave sipas veprimtarive**

## SWOT Analiza

### Përparësitë

Ibër-Lepenc ka identifikuar pérparësitë në vijim:

- Tregu stabil i shërbimeve që ofron Ndërmarrja;
- Operator i vetëm i hidrosistemit në Kosovën qendrore;
- Prodhues i hidro – energjisë;
- Kërkesat në rritje për ujë të papërpunuar;
- Ofrues i vetëm i shërbimeve të ujitjes dhe ujit të papërpunuar;

### Dobësitë

Ndërsa dobësitë e identikuara janë:

- Asetet e vjetruara që kërkojnë mirëmbajtje apo zëvendësim dhe kostoja e tyre është e lartë;
- Shfrytëzim në shkallë të ulët i kapaciteteve për ujitje;
- Mungesa e një infrastrukturë moderne-të digjitalizuar të proceseve;
- Gjendja ekonomike jo e mirë e disa shfrytëzuesve të shërbimeve;

### Mundësitë

Disa nga mundësitë të cilat ndihmojnë veprimtarinë e Ndërmarrjes janë:

- Ekzistimi i infrastrukturës operacionale;
- Mundësia e gjenerimit të energjisë në kohë të pik-ut;
- Kapacitetet e ujitjes janë shumë më të mëdha se sa kërkesat aktuale të shfrytëzueshme nga fermerët;

### Rreziqet

Ibër Lepenci po ashtu ballafaqohet me një numër të rreziqeve të listuara më poshtë:

- Fatkeqësitë elementare natyrore (reshjet e mëdha, rrëshqitjet e tokës, vërshimet etj.) mund të ndikojnë në dëmtimin e aseteve të ndërmarrjes;
- Thatësia ekstreme mund të rrezikojë realizimin e gjenerimit të planifikuar të energjisë elektrike;
- Mos arkëtimi i mjeteve nga klientët me kohë dhe borxhet e këqija;
- Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore në hidrosistem për shkak të ndërrimit të destinacionit nga toka bujqësore në toka urbane;
- Shpenzimet e larta në sektorin e ujitjes si pasojë e zhvlerësimit të hidrosistemit;
- Mos furrnizimin me ujë të KRUM dhe KURP si dhe Kosova A e B por edhe Ferronikeli!

### **Veprimtaria**

Ibër-Lepenc është shoqëri aksionare dhe si ndërmarrje publike hidroekonomike merret me shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sistemit shumë-funksional përfurnizim me ujë dhe gjenerim të energjisë elektrike. Asetet kryesore të ndërmarrjes janë:

- **Diga në Ujman**-mundëson akumulimin e ujit i cili përdoret përfornimin e energjisë elektrike si dhe Hidrocentrali "Ujman";
- **Kanali kryesor "Pridvoricë – Obiliq"** në gjatësi prej 50 km- mundëson furnizimin e industrisë me ujë të papërpunuar përfthohje përf KER – termocentralet "Kosova A", "Kosova B", Ferronikeli dhe përfurnizimin e ujësjellësve regional në Mitrovicë dhe Prishtinë të cilët furnizonë qytetarët me ujë të pijshëm.
- **Rrjeti nëntokësor** -mundëson furnizimin e bujqësisë me ujë përf ujitje.

Aktualisht tregjet e NH "Ibër- Lepenc" Sh.A. janë stabile dhe të sigurta. Konsumatorë të ndërmarrjes janë: KER-u; KRU "Mitrovica", së bashku me ujësjellësin në Vushtrri; KUR "Prishtina" - përf Shkabaj; KUR "Prishtina" përf Drenas; "Feronikeli".

### **Energjia Elektrike**

Gjenerimi i energjisë elektrike është një aktivitet shumë i rëndësishëm përfndërmarrjen. Si i tillë, ky aktivitet sjellë të hyra të konsiderueshme dhe duke pasur parasysh kërkuesat dhe mungesën e energjisë elektrike në Kosovë dhe rajon, tregu i energjisë elektrike konsiderohet një treg i sigurt i cili do të vazhdojë ta mbajë stabile gjendjen financiare të ndërmarrjes përf një kohë të gjatë.

### **Uji i papërpunuar**

Ujësjellësi regional i Mitrovicës per Shipol, do të furnizohet me ujë të papërpunuar bazuar në ujëmatës në sasi prej mesatares  $0.664 \text{ m}^3/\text{sec}$ , ndërsa përf Balincë planifikohet sasi prej  $0.28 \text{ m}^3/\text{sec}$ . Ndërsa Ujësjellësi i Prishtinës bazuar në ujëmatës (përf Drenas) në sasi prej  $0.105 \text{ m}^3/\text{sec}$ . Furnizimi me ujë të papërpunuar përf KUR "Prishtina"-Shkabaj do të jetë me sasi maksimale prej  $0.700 \text{ m}^3/\text{sec}$ . Çmimi përf këtë furnizim është  $0.0433 \text{ €}/\text{m}^3$ .

Tarifat apo çmimi i ujit të papërpunuar përf ujësjellësit është i rregulluar nga ARRU me sistem dytarifor: përf ujësjellësin e Mitrovicës me çmim prej  $0.0201 \text{ €}/\text{m}^3$ , dhe përf ujësjellësin e Prishtinës  $0.0433 \text{ €}/\text{m}^3$ .

Termocentrali "Kosova B" dhe "Kosova A" furnizohen me ujë të papërpunuar në sasi  $0.340 \text{ m}^3/\text{sec}$  dhe  $0.5 \text{ m}^3/\text{sec}$ , respektivisht. Çmimi përf këtë furnizim është  $0.065 \text{ €}/\text{m}^3$ .

Feronikeli furnizohet me  $0.067 \text{ m}^3/\text{sec}$ . Çmimi përf këtë furnizim është  $0.085 \text{ €}/\text{m}^3$ .

Para se të paraqiten projektimet e furnizimit me ujë në formë tabelare përmbledhëse dhe të detajuar do të paraqiten disa shpjegime rreth projektimit për vitin 2025.

Projektimi i sasive më të ulëta të ujit të papërpunuar për vitin 2025, në krahasim me realizimin e vitit 2024, është ndërtuar mbi disa faktorë kryesorë:

1. **Thatësia ekstreme e vitit 2024** – Ky vit ka qenë atipik për shkak të një thatësie të pazakontë, e cila shkaktoi një rritje të kërkesës për ujë nga të gjithë konsumatorët. Një tregues i kësaj ishte tharja e lumenit LLap dhe kërkesa e jashtëzakonshme e TC Kosova A përfundim me 350-450 l/s, për herë të parë.
2. **Kufizimet menaxheriale në kontrollin e ujëmarrësve** – Ndërmarrja ka kontroll të kufizuar mbi shumicën e ujëmarrësve, përvèç TC Kosova A dhe TC Kosova B. Konsumatorët e tjerë marrin ujë direkt nga kanali kryesor sipas nevojave të tyre, pa njoftim dhe aprovim paraprak, çka e bën të vështirë parashikimin e saktë të konsumit.
3. **Bazat e projektimit për vitin 2025** – Projektimi për këtë vit është bazuar në:
  - Trendet historike të konsumit, duke përjashtuar vitin 2024 për shkak të kushteve ekstreme;
  - Modelet normale të kërkesës për ujë nga vitet e mëparshme;
  - Parashikimet më realiste që pasqyrojnë kushte normale klimatike.

Kjo qasje më konservatore në projektim siguron një planifikim më të qëndrueshëm, duke shbangur mbivlerësimin e nevojave që mund të rezultonte nga përfshirja e të dhënavë të vitit 2024, kur kërkesa për ujë ishte e jashtëzakonshme dhe nivelet në Ujman ishin të ulëta.

Projektimi i ulët për vitin 2025 nuk duhet të shihet si nënverhësim i nevojave, por si një pasqyrim më realist i kërkesës për ujë në kushte normale operative. Gjithashtu, duhet marrë parasysh që shumica e konsumatorëve kanë qasje të drejtpërdrejtë në kanal dhe rregullojnë vetë marrjen e ujit sipas nevojave të tyre, gjë që ndikon në parashikimet e planifikimit të ndërmarrjes.

**Tabela 1: PLANI I SASIVE TË UJIT SIPAS KONSUMATORVE PËR VITIN 2025**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	Uji i papërpunuar	m <sup>3</sup>	62,950,550	61,212,220	97.24
1.1	Ujësjellsat	"	47,411,390	46,282,980	97.62
1.2	Kosova A dhe B	"	13,490,520	12,887,860	95.53
1.3	Ferronikeli	"	2,048,640	2,041,380	99.65
2	Ujitja	"	5,696,080	6,175,000	108.41
	Gjithsej:		68,646,630	67,387,220	98.17

**Tabela 1.1 : Plani I furnizimit me ujë të papërpunuar për vitin 2025 -Shkabaj**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"KUR" Prishtinë-Shkabaj	m <sup>3</sup>	1,252,500	1,185,700	94.67
Shkurt	"	"	1,215,900	1,130,500	92.98
Mars	"	"	1,316,400	1,250,500	94.99
Prill	"	"	1,243,800	1,295,540	104.16
Maj	"	"	1,339,500	1,305,500	97.46
Qershori	"	"	1,239,300	1,304,300	105.24
Korrik	"	"	1,439,600	1,458,680	101.33
Gusht	"	"	1,525,200	1,418,500	93.00
Shtator	"	"	1,353,700	1,299,550	96.00
Tetor	"	"	1,187,080	1,306,590	110.07
Nentor	"	"	1,148,790	1,289,550	112.25
Dhjetor	"	"	1,187,080	1,295,560	109.14
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>15,448,850</b>	<b>15,540,470</b>	<b>100.59</b>

**Tabela 1.2 : Plani I furnizimit me ujë të papërpunuar për vitin 2025-Drenas**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"KUR" Prishtinë-Drenas	m <sup>3</sup>	343,390	343,390	100.00
Shkurt	"	"	294,610	294,610	100.00
Mars	"	"	318,970	318,970	100.00
Prill	"	"	259,630	259,630	100.00
Maj	"	"	300,880	300,880	100.00
Qershori	"	"	330,690	330,690	100.00
Korrik	"	"	335,780	335,780	100.00
Gusht	"	"	349,340	349,340	100.00
Shtator	"	"	340,010	334,810	98.47
Tetor	"	"	295,870	295,870	100.00
Nentor	"	"	289,700	289,700	100.00
Dhjetor	"	"	280,130	280,130	100.00
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>3,739,000</b>	<b>3,733,800</b>	<b>99.86</b>

**Tabela 1.3 : Plani I furnizimit me ujë të papërpunuar për vitin 2025-Shipol**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"KRU" Mitrovicë-Shipol	m <sup>3</sup>	1,745,210	1,558,400	89.30
Shkurt	"	"	1,583,950	1,450,800	91.59
Mars	"	"	1,668,250	1,589,350	95.27
Prill	"	"	1,665,850	1,615,250	96.96
Maj	"	"	1,709,050	1,680,060	98.30
Qershori	"	"	1,829,430	1,685,430	92.13
Korrik	"	"	1,937,650	1,850,760	95.52
Gusht	"	"	1,854,530	1,894,510	102.16
Shtator	"	"	1,740,970	1,625,360	93.36
Tetor	"	"	1,652,830	1,675,350	101.36
Nentor	"	"	1,651,700	1,328,590	80.44

Dhjetor	"	"	1,626,090	1,605,430	98.73
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>20,665,510</b>	<b>19,559,290</b>	<b>94.65</b>

**Tabela 1.4 : Plani i furnizimit me ujë të papërpunuar për vitin 2025-Balinc**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"KRU" Mitrovicë.-Balinc	m <sup>3</sup>	600,590	525,000	87.41
Shkurt	"	"	594,540	520,500	87.55
Mars	"	"	644,890	605,870	93.95
Prill	"	"	623,430	620,850	99.59
Maj	"	"	670,690	660,590	98.49
Qershori	"	"	677,120	645,550	95.34
Korrik	"	"	767,410	685,450	89.32
Gusht	"	"	801,110	625,850	78.12
Shtator	"	"	612,500	629,850	102.83
Tetor	"	"	527,590	658,750	124.86
Nentor	"	"	510,570	645,730	126.47
Dhjetor	"	"	527,590	625,430	118.54
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>7,558,030</b>	<b>7,449,420</b>	<b>98.56</b>

**Tabela 1.5 : Plani i furnizimit me ujë industrial për vitin 2025-"Kosova A"**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"Kosova A"	m <sup>3</sup>			
Shkurt	"	"			
Mars	"	"			
Prill	"	"			
Maj	"	"			
Qershori	"	"			
Korrik	"	"	745,560	600,000	80.48
Gusht	"	"	1,192,320	700,000	58.71
Shtator	"	"	527,040	550,300	104.41
Tetor	"	"			
Nentor	"	"			
Dhjetor	"	"			
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>2,464,920</b>	<b>1,850,300</b>	<b>75.07</b>

**Tabela 1.6 : Plani i furnizimit me ujë industrial për vitin 2025-"Kosova B"**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	"Kosova B"	m <sup>3</sup>	937,440	937,440	100.00
Shkurt	"	"	876,960	846,720	96.55
Mars	"	"	937,440	937,440	100.00
Prill	"	"	907,200	907,200	100.00
Maj	"	"	937,440	937,400	100.00
Qershori	"	"	907,200	907,200	100.00
Korrik	"	"	937,440	937,440	100.00
Gusht	"	"	937,440	937,440	100.00
Shtator	"	"	907,200	907,200	100.00

Tetor	"	"	923,050	937,440	101.56
Nentor	"	"	893,740	907,200	101.51
Dhjetor	"	"	923,050	937,440	101.56
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>11,025,600</b>	<b>11,037,560</b>	<b>100.11</b>

**Tabela 1.7 : Plani i furnizimit me ujë industrial për vitin 2025-Feronikeli**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	Feronikeli	m <sup>3</sup>	195,340	194,360	99.50
Shkurt	"	"	164,330	160,660	97.77
Mars	"	"	174,360	174,360	100.00
Prill	"	"	144,220	150,000	104.01
Maj	"	"	149,300	154,000	103.15
Qershor	"	"	154,940	162,000	104.56
Korrik	"	"	166,460	170,000	102.13
Gusht	"	"	172,170	170,000	98.74
Shtator	"	"	156,030	165,000	105.75
Tetor	"	"	197,030	192,500	97.70
Nentor	"	"	188,210	159,000	84.48
Dhjetor	"	"	186,250	189,500	101.74
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>2,048,640</b>	<b>2,041,380</b>	<b>99.65</b>

### Ujitja

Ndërmarrja "Ibër- Lepenc" ka një sistem modern të ujitjes, i cili shtrihet në pjesën veri-lindore dhe qendrore të Kosovës me qëllim të rritjes së prodhimitarisë bujqësore në këtë regjion. Megjithatë, duhet theksuar se bazuar në jetëgjatësinë e hidrosistemit, i njëjtë është zhvlerësuar.

**Tabela 2: PLANI I FURNIZIMIT ME UJË PËR UJITJE PËR VITIN 2025**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	Ujitja	m <sup>3</sup>			
Shkurt	"	"			
Mars	"	"			
Prill	"	"			
Maj	"	"			
Qershor	"	"	854,400	926,250	108.41
Korrik	"	"	1,993,640	2,161,250	108.41
Gusht	"	"	1,993,640	2,161,250	108.41
Shtator	"	"	854,400	926,250	108.41
Tetor	"	"			

Nentor	"	"			
Dhjetor	"	"			
<b>Gjithsej:</b>		"	<b>5,696,080</b>	<b>6,175,000</b>	<b>108.41</b>

### Plani operativ dhe investiv

Plani i operimit dhe mirëmbajtjes për vitin 2025 është përpiluar në bazë të kërkesave të shfrytëzuesve të ujit të papërpunuar për Ujësjellësit dhe industrinë: KEK-u; KUR "Prishtina" – Shkabaj; KUR "Prishtina" për Drenas; KRU "Mitrovica", së bashku me ujësjellësin në Vushtrri; "Feronikeli".

### Gjenerimi i energjisë elektrike-

Gjenerimi i energjisë elektrike varet nga kushtet hidrologjike dhe niveli i ujit në akumulimin e Ujmanit. Duke qenë se niveli aktual i ujit në liqe është në kuotat optimale si rrjedhojë e kushteve hidrometeorologjike planifikuar prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2025 prej 83,000 MWh. Ky prodhim është mbi mesataren shumëvjeçarë të gjenerimit në Hidrocentral.

Kjo rritje është bërë me kujdes të shtuar, duke pasur parasysh edhe nevojat e furnizimit me ujë shumë të favorshme, krahasuar me mesataret shumë vjeçare, ndërmarrja ka të konsumatorëve me interes nacional siç janë KEK-ut, KUR Prishtina, KRU Mitrovica.

**Tabela 3 : PLANI I GJENERIMIT ENERGJISË ELEKTRIKE PER VITIN 2025**

Muaji	Emërtimi	Nj.mat	Realizimi 2024	Plani 2025	Indeksi %
1	2	3	4	5	6(5:4)
Janar	Energjia elektrike	MWh	6,513.81	6,500	99.79
Shkurt	"	"	6,286.30	6,500	103.40
Mars	"	"	5,501.73	8,000	145.41
Prill	"	"	7,965.16	8,000	100.44
Maj	"	"	7,720.68	8,000	103.62
Qershor	"	"	5,408.00	7,000	129.44
Korrik	"	"	5,497.50	6,000	109.14
Gusht	"	"	4,778.74	6,000	125.56
Shtator	"	"	3,652.83	6,000	164.26
Tetor	"	"	5,500.00	7,000	127.27
Nëntor	"	"	6,000.00	7,000	116.67
Dhjetor	"	"	6,000.00	7,000	116.67
	<b>GJITHSEJ:</b>		<b>70,824.75</b>	<b>83,000</b>	<b>117.19</b>

### Ujitja me sipërfaqet e planifikuara sipas Njësive Punuese dhe fushave për vitin 2025

Në vitin 2025 N.H. "Ibër-Lepenc" Sh.A planifikon që sipas rregullores për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes më datë 01.06.2025, të filloj mbushjen e sistemit të ujitjes dhe atë në rreth 11,000 ha, por bazuar në kërkosat e fermerëve si dhe bazuar në sipërfaqet e ujitura në vitet e kaluara, planifikojmë që fermerët do të ujin 1,900 ha: në Vushtri 850 ha, në Shkabaj 740 ha dhe në Komoran 310 ha.

**Tabela 4 :SIPËRFAQET E UJITURA PËR VITET 2022-2024 DHE TË PLANIFIKUARA PËR UJITJE NË VITIN 2025 NË HEKTARË - ha**

Njësia Punuese	Sipërfaqet projektuese	Sipërfaqet e rehabilituara	Sipërfaqet e ujitura	Sipërfaqet e ujitura	Sipërfaqet e ujitura	Sipërfaqet e planifikuara	Indeksi %
			2022	2023	2024	2025	
1	2	3	5	6	7	8	9(8:7)
Vushtri	7,200	4,500	734.28	655.30	824.39	850	103
Shkabaj	7,100	2,500	685.81	601.66	727.39	740	102
Komoran	5,620	4,000	459.63	111.37	200.84	310	154
	<b>19,920</b>	<b>11,000</b>	<b>1,879.72</b>	<b>1,368.33</b>	<b>1,752.62</b>	<b>1,900</b>	<b>108</b>

**Tabela.4.1 : Nj.P. VUSHTRRI - Siperfaqët e planifikuara për ujitje sipas fushave për vitin 2025**

Nr.	Emërtimi i Fushës	Njësia matëse	Sipërfaqët e përfshira në ujitje	Sipërfaqet e mundëshme për ujitje	Sipërfaqet e ujitura 2024	Sipërfaqët e planifikuara ha. 2025	Indeksi 2025/2024 %
1	Fusha e Mitrovicës	ha	1,415.00	1,027.00	383.26	350.00	91.32
2	Fusha e Nadakovcit	"	1,348.00	1,128.00	221.13	245.00	110.79
3	Fusha Madhe	"	290.00	204.00	43.40	50.00	115.21
4	Fusha e Llapit	"	366.00	201.00	29.60	35.00	118.24
5	Fusha e Nevolanit	"	285.00	215.00	43.70	50.00	114.42
6	Fusha e Ibrit	"	231.00	-	34.45	30.00	87.08
6	Fusha e Mihaliquit	"	150.00	136.00	41.00	50.00	121.95
7	Fusha e Banjskës (S.P.)	"	734.00	-	-	-	
8	Fusha e Samadrexhës (S.P.)	"	1,386.00	735.00	19.35	20.00	103.36
9	Fusha e Pantinës	"	995.00	854.00	8.50	20.00	235.29
	<b>T O T A L I :</b>	"	<b>7,200.00</b>	<b>4,500.00</b>	<b>824.39</b>	<b>850.00</b>	<b>103.11</b>

**Tabela.4.2 : Nj.P. SHKABAJ - Siperfaqët planifikuara**

Nr.	Emërtimi i Fushës	Njësia matëse	Sipërfaqët e përfshira në ujitje	Sipërfaqet e mundëshme për ujitje	Sipërfaqet e ujitura 2024	Sipërfaqet e planifikuara për ujitje për vitin 2025	Indeksi 2025/2024 %
1	Fusha Bardhosh (J)	ha	1,219.00	1,019.00	266.20	290.00	108.94
1.1.	Pompë mobile	"	189.00	-		-	
1.2.	Pompë mobile	"	169.00	-		-	
2	Fusha e Kosovës (KP)	"	628.00	-		-	
2.1.	K.P.-7,pom.mobile	"	176.00	-		-	
2.2.	K.P.-9,pom.mobile	"	189.00	-		-	
3	Fusha e Milloshevës (A)	"	1,686.00	1,481.00	461.19	450.00	97.57
3.1.	A' -pom.mobile	"	227.30	-		-	
3.2.	A'' -pom.mobile	"	231.70	-		-	
4	Fusha e Llapit (ujit.siperf)	"	658.00	-		-	
5	Fusha e Graçanicës	"	-	-		-	
5.1.	G-2 (ramje e lirë)	"	389.00	-		-	
5.2.	G-3 (ramje e lirë)	"	420.00	-		-	
5.3.	G-4 (ramje e lirë)	"	204.00	-		-	
5.4.	G-5 (ramje e lirë)	"	247.00	-		-	
5.5.	G-6 (ramje e lirë)	"	219.00	-		-	
5.6.	G-7 (ramje e lirë)	"	248.00	-		-	
<b>T O T A L I:</b>		"	<b>7,100.00</b>	<b>2,500.00</b>	<b>727.39</b>	<b>740.00</b>	<b>101.73</b>

Tabela.4.3 : Nj.P. KOMORAN - Siperfaqët e planifikuara për ujitje për vitin 2025

Nr.	Emërtimi i Fushës	Njësia matëse	Sipërfaqët e përfshira në ujitje	Sipërfaqet e mundëshme për ujitje	Sipërfaqet e ujitura 2024	Sipërfaqë e planifikuara ha. 2025	Indeksi 2025/2024 %
1	DK-1- presion me ramje	ha	282.00	262.00	20.51	30.00	146.27
2	DK-2- prsion me ramje	"	682.00	232.00	-	15.00	
3	LK - 3-presion me ramje	"	137.00	108.00	20.64	35.00	169.57
4	DP - 1 - S.P.Gllobar	"	865.00	345.00	22.90	35.00	152.84
5	DP- 2 - S.P.Gllobar	"	674.00	569.00	36.65	45.00	122.78
6	LP - 1- S.P.Korrotice	"	1,138.00	363.00	22.90	35.00	152.84
7	LP - 2 - S.P.Gjurashin	"	468.00	438.00	26.43	40.00	151.34
8	LP - 3 - S.P.fushticë	"	544.00	314.00	24.96	25.00	100.16
9	LP - 4 - S.P.Fushtice	"	830.00	182.00	25.85	50.00	193.42
<b>T O T A L I:</b>		"	<b>5,620.00</b>	<b>2,813.00</b>	<b>200.84</b>	<b>310.00</b>	<b>154.35</b>

## Investimet Kapitale

Ky plan mund të arrihet me operim dhe mirëmbajtje të vazdueshme të aseteve ekzistuese dhe investime në rehabilitimin e aseteve.

Në veçanti do të bëhen investime në:

- *Infrastrukturë*
  - Rehabilitimi i një pjese të kanalit kryesor parashihet të kryhet me planin e biznesit për vitin 2025 pasi që ky rehabilitim ka filluar në vitin 2023 nga mjetet e huas së lejuar nga Banka Botërore.
  - Revitalizimi dhe modernizimi i sistemit të "Ibër-Lepenc" -it,
  - Digitalizimi i dokumentacionit teknik të ndërmarrjes.
- *Ngritjen e kapaciteteve*
  - Trajnine profesionale të menaxhmentit dhe stafit tjetër.

## Departamenti Uji dhe Gjenerimi

1. **Remonti i pajisjeve hidroturbine të aggregatëve "A" dhe "B" në HC** - Planifikohet remonti i pajisjeve hidroturbine të aggregatëve "A" dhe "B", që përfshinë shqyrtimin e valvulave paraturbinore në formë fluture, inspektimin dhe remontin e valvulave hidraulike bypass, blerjen e valvulave të reja manuale bypass, inspektimin e vulave të gomës, mbulesave dhe unazave "O" mes teheve fjinje të aparatit udhëzues, inspektimin e rrotave të punës së turbinave, kapakëve të rrotave të turbinës, vulave të karbonit, mbrojtjen kundër korrozionit të spiralit, ndërhyrjet në menaxhimin e përgatitjes së vajit rregullues dhe hartimin e raportit teknik.
2. **Rikonstruksioni i panelit komandues/kontrollues të dy njësive gjeneruese** - Punimet përfshijnë rikonstruktimin dhe modernizimin e paneleve komanduese të gjeneratorëve A dhe B në HC Ujmani. Elektrana aktualisht ka një sistem të automatizuar nga vitet 1970, që mbështetet në reje industriale të vjetra dhe karta komandimi për mbledhjen e sinjaleve kontrolluese. Pjesët rezervë për këtë pajisje janë shteruar vitet e fundit, dhe është bërë e vështirë blerja e këtyre pjesëve, pasi ato nuk prodhohen më. Punimet përfshijnë heqjen e pajisjeve të vjetra dhe zëvendësimin e tyre me sisteme më moderne dhe të besueshme të bazuara në kontrollin mikroprocesorial. Kjo do të rrisë besueshmërinë e funksionimit të gjeneratorëve dhe prodhimin më të qëndrueshëm të energjisë elektrike. Pajisjet e reja do të ofrojnë gjithashtu një pasqyrë më të qartë të gjendjes së pajisjeve të tjera të elektranës, duke mundësuar monitorimin në kohë reale dhe informimin e shpejtë për prishjet dhe funksionimin e sistemeve të tjera ndihmëse.
3. **Ndërtimi i objektit të rojes dhe hapësirës së magazinës në digën "Pridvorica"** - Në digën e vogël "Pridvorica" gjendet një kabinë për roje që është e lidhur me hapësirën e magazinës dhe panelet komanduese. Ky objekt është në gjendje shumë të keqe, dhe nuk ofron kushte të përshtatshme për punonjësit. Parashikohet rindërtimi i plotë i këtij objekti dhe rregullimi i hapësirës së magazinës.
4. **Furnizimi i një gjeneratori 70 kVA për digën e Ujmanit** - Për shkaqe operative, në raste të emergjencave është i nevojshëm blerja e një gjeneratori të ri naftë me kapacitet 70 kVA për sigurimin e energjisë rezervë në digën e Ujmanit.

5. **Riparimi i pistonit nr.1 të portës A në digën Pridvorica** - Propozohet remont i pistonit nr. 1 të portës A në digën e Pridvoricës për shkak të rënies së presionit të vajit. Plani përfshin shqyrtimin e cilindrit, zëvendësimin e pjesëve të konsumuara dhe riprogramimin e sistemit PLC. Ky veprim është kritik për sigurinë dhe funksionimin e pandërprerë të digës së Pridvoricës
6. **Furnizim me shufra të Statorit për nevoja të HC Ujmani** - Nevojitet blerja e shufrave të sipërme të statorit të gjeneratorit (2 copë). Këto shufra prodhohen sipas vizatimeve dhe dimensioneve të kërkua, nga bakri i cilësisë së lartë. Shufrat janë të nevojshme si pajisje rezervë, sepse në rastet e avarive në gjeneratorë, koha e riparimit do të reduktohet, gjë që është shumë e rëndësishme nga këndvështrimi ekonomik për një njësi të tillë prodhuese.
7. **Furnizimi me inventar për nevoja të NJP Ujmani** - Nevojitet blerja e inventarit të ri për të pajisur plotësisht dhomën komanduese, zyrat e inxhinierëve dhe zyrat e mbikëqyrësve të punimeve elektrike dhe mekanike.
8. **Furnizimi me Pompa të Ujit për nevoja operative** - Pompat e ujit janë të domosdoshme për raste emergjente, veçanërisht në situatat e përbrytjeve ose rritjes së nivelit të ujit. Ato shërbejnë për zbrazjen e pusetave dhe për ndërhyrje të tjera në terren, duke siguruar një përgjigje të shpejtë ndaj situatave kritike. Pajisja e sistemit me këto pompa siguron mbrojtje më të mirë ndaj përbrytjeve dhe efikasitet në menaxhimin e ujit.
9. **Riparimi i Pompave të Drenazhit në SP Besi, SP Bivolak dhe SP Samadrexhë** - Riparimi dhe servisimi i pompave të drenazhit janë të domosdoshme për të garantuar funksionimin e duhur në rast të rritjes së nivelit të ujit. Ndërrimi i kushinetave dhe mirëmbajtja e përgjithshme përmirëson qëndrueshmërinë dhe performancën e këtyre pompave, duke siguruar gatishmërinë për sezonin e ujitjes dhe emergjencat tjetra.
10. **Tepih i Gomës dhe Pajisje të Tensionit për SP Besi dhe SP Bivolak** - Tepihu i gomës, dorëzat dhe qizmet e tensionit të lartë janë të domosdoshme për mbrojtjen e operatorëve nga elektriciteti gjatë punëve në stabilimentet e tensionit të lartë (35kV). Furnizimi me këto pajisje garanton sigurinë e stafit dhe zbatimin e standardeve të larta të mbrojtjes në punë.
11. **Ndërrimi i Tabelave Komanduese në SP Gjurashin dhe SP Krashticë (Globar)** - Tabelat komanduese të amortizuara në SP Gjurashin dhe SP Krashticë kanë nevojë për zëvendësim për shkak të problemeve të vazhdueshme me funksionimin e pompave. Ndërrimi i sistemit të komandimit është i domosdoshëm për të siguruar një operacion të besueshëm dhe efikas, si dhe për të parandaluar avaritë e papritura.
12. **Rindërtimi i pjesëve të segmentit të Kanalit Besi-Graçankë** - Rindërtimi dhe rekonstruksi i segmenteve të Kanalit Mihaliq-Besi-Graçankë është një domosdoshmëri për përmirësimin e funksionalitetit dhe eficiencës së rrjedhjes së ujit. Ky projekt do të zvogëlojë humbjet e ujit dhe do të adresojë problemet e rrjedhjeve ekzistuese që shkaktojnë dërtime të pronave private dhe shqetësimë për komunitetin përeth. Me ndërhyrjet e planifikuar në segmente të ndryshme të kanalit, përfshire rindërtimin e segmenteve trapezoidale dhe riparimin e fugave dilatuese, projekti synon të përmirësojë stabilitetin dhe kapacitetin e sistemit. Ky investim do të ndikojë pozitivisht në ruajtjen e pronave private dhe uljen e kostove të mirëmbajtjes afatgjatë.
13. **Studim Fizibiliteti lidhur me rehabilitimin, modernizimin dhe rritjen e eficiencës së Hidrocentralit** - Një studim i fizibilitetit është një hap thelbësor për të përcaktuar mundësitë dhe sfidat e rehabilitimit, modernizimit dhe rritjes së eficiencës së hidrocentralit. Më poshtë paraqiten disa nga arsyet kryesore që e bëjnë këtë studim të domosdoshëm:
  - a. **Amortizimi i teknologjisë dhe infrastrukturës** - Hidrocentrali ynë është ndërtuar në vitet '70-ta i cili është bazuar në teknologji të vjetruar, të cilat nuk janë më në përputhje me standardet e sotme të sigurisë dhe eficiencës energetike. Sistemi i kontrollit, pajisjet mekanike dhe elektrike, si dhe materialet e përdorura, janë të amortizuara. Një studim fizibiliteti do të analizonte gjendjen aktuale të infrastrukturës dhe do të vlerësonte se cilat

pjesë kanë nevojë për rehabilitim të plotë ose zëvendësim për të garantuar një funksionim të qëndrueshëm.

- b. **Efiçienca energjetike dhe përmirësimi i prodhimit** - Teknologjitet e reja kanë rritur ndjeshëm eficiencën në prodhimin e energjisë elektrike nga burime hidroenergjitime. Një hidrocentral i ndërtuar në vitet '70 -ta, me pajisje të vjetër uara ka një eficiencë më të ulët në krahasim me standardet bashkëkohore. Një studim fizibiliteti do të analizonte se si mund të optimizohet ky potencial duke modernizuar pajisjet e turbinave, gjeneratorëve dhe sistemet e kontrollit, në mënyrë që hidrocentrali të prodhojë më shumë energji me të njëjtën sasi ujë të përdorur.
  - c. **Siguria dhe përputhshmëria me standarde aktuale** - Me kalimin e viteve, standarde e sigurisë dhe rregulloret për hidrocentralet janë bërë më të rrepta, sidomos lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e rezikut të fatkeqësive natyrore. Një studim fizibiliteti do të analizonte nëse hidrocentrali aktual përbush këto standarde dhe çfarë ndërhyrjesh janë të nevojshme për të garantuar që hidrocentrali të jetë në përputhje me rregulloret e reja. Siguria e strukturës së digës dhe pajisjeve mekanike është thelbësore për të parandaluar çdo rezik të mundshëm.
  - d. **Përmirësimi i qëndrueshmërisë dhe zvogëlimi i kostove të mirëmbajtjes** - Pajisjet e vjetra kanë një tendencë të lartë për prishje dhe kërkijnë mirëmbajtje të shpeshtë, gjë që çon në kosto më të larta operacionale dhe ndërprerje të funksionimit. Studimi i fizibilitetit do të ndihmonte në identifikimin e fushave ku investimet në modernizim do të ulin ndjeshëm kostot operative afatgjata dhe do të rrisin qëndrueshmërinë e hidrocentralit.
  - e. **Përshtatja me kërkkesat e tregut të energjisë dhe sfidat klimatike** - Me ndryshimet në tregjet e energjisë dhe kërkësën për energji të pastër dhe të qëndrueshme, hidrocentrali ka një rol strategjik për të kontribuar në plotësimin e këtyre nevojave. Një studim fizibiliteti do të shqyrton mundësitë e zgjerimit të kapaciteteve ose adaptimit të teknologjive të reja për të rritur fleksibilitetin e prodhimit të energjisë, duke marrë parasysh ndryshimet klimatike dhe menaxhimin e resurseve ujore.
  - f. **Financimi dhe kthimi i investimit** - Një rehabilitim dhe modernizim i suksesshëm kërkon një investim të konsiderueshëm kapitali. Studimi i fizibilitetit do të sigurojë një analizë të detajuar financiare për të vlerësuar kostot dhe përfitimet e investimit, duke identifikuar mundësitë për financim nga burime të ndryshme, përfshirë institucionet ndërkombëtare dhe qeveritare. Një analizë e kthimit të investimit është thelbësore për të përcaktuar nëse rehabilitimi është ekonomikisht i qëndrueshëm.
14. **Makineri për pastrimin e kanaleve dhe vegjetacionit** - Kjo makineri paraqet një zgjidhje efikase dhe shumë funksionale për pastrimin dhe mirëmbajtjen e kanaleve. Dizajni i saj i bazuar në një skid-steer me krah të zgjatur (boom arm) dhe kositëse (mower) ofron disa avantazhe të rëndësishme gjatë pastrimit të vegjetacionit, si dhe mund të përdoret për pastrimin e sedimentit në kanale sekondare.
